

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ME SELI NË TIRANË
ECO CAR WASH ALBANIA SH.P.K.

Sot, më datë 22.02.2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), ortakët themelues:

- **Flavieta BALA**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë (Shqiperi) më datë 20/04/1980 dhe me vendbanim ne Tirane, Shqiperi, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e e Kartës së Identitetit me Nr. 029988440 dhe numër personal I05420213M;
- **Marko BRINJA**, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë (Shqiperi) më datë 27/01/1996 dhe me vendbanim ne Vlorë, Shqiperi, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i Kartës së Identitetit me Nr. 032728366 dhe numër personal J60127086E.

të cilët nëpërmjet këtij akt-themelimi vendosën themelimin e shoqërisë **“ECO CAR WASH ALBANIA” Sh.p.k.**, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare **“ECO CAR WASH ALBANIA” Sh.p.k.**, themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 **“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”**, i ndryshuar (këtu e më poshtë **Shoqëria**).

Shoqëria është një person juridik shqiptar.

NENI 2

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **“ECO CAR WASH ALBANIA” Sh.p.k.**
Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka per objekt veprimtarie:

- pastrim me avull i brendshëm dhe i jashtëm i makinave;
- pastrim me avull, higjienizim i tapicerisë së makinave dhe objekteve të ndryshme;
- rinovim dhe mbrojtje e lëkurës së makinave dhe objekteve të ndryshme;
- riparim i lëkurës së makinave e të objekteve të ndryshme;
- shërbime të detajuara të automjeteve: ilustrim i karrocërisë, dritave dhe xhamave;

- blerje dhe shitje e produkteve, detergjentëve dhe materialeve të ndryshme për pastrimin me avull të makinave;
- blerje dhe shitje të makinerive për pastrimin me avull të makinave;
- krijim dhe zhvillim të rrjetit të franchise-it në nivel kombëtar.

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njesia Administrative Farke, Rr. Shyqeri Brari, Pallati 11, Kati minus 1, Farke, Tiranë.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kontributi në para do të ketë një vlerë të përgjithshme prej 5.000,00 (Pesëmijë) Euro i ndarë në 2 kuota.

Ortakët themelues të Shoqërisë tregtare "ECO CAR WASH ALBANIA" Sh.p.k. zotërojnë kuotat në shoqëri si më poshtë:

1. **Flavieta BALA**, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50% të vlerës së kapitalit themeltar të barabartë me një kuota me vlerë të përgjithshme prej 2.500,00 (dymije e peseqind) Euro;
2. **Marko BRINJA**, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50% të vlerës së kapitalit themeltar të barabartë me një kuota me vlerë të përgjithshme prej 2.500,00 (dymije e peseqind) Euro.

Kapitali themeltar është derdhur në total nga Ortakët themelues. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga ortakët me miratimin e këtij Akti Themelimi.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është 1 pa përcaktuar dhe mund të ndryshohet një ose disa herë me vendim të Asamblesë së Ortakëve

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm/ Ortakëve – organi më i lartëvendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen për një mandat pesëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratorë të Shoqërisë do të jenë:

- (1) **Flavieta BALA**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë (Shqiperi) më datë 20/04/1980 dhe me vendbanim ne Tirane, Shqiperi, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e e Kartës së Identitetit me Nr. 029988440 dhe numër personal I05420213M;
- (2) **Monika BAQLI**, shtetase shqiptare, lindur në Vlorë (Shqiperi) më datë 03/04/1978 dhe me vendbanim ne Tirane, Shqiperi, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e Kartës së Identitetit me Nr. 029243684 dhe numër personal H85403067M.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara ç'do organi administrativ, gjyqësor, apo ç'do entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratoret e shoqërisë, te cilet ushtrojne të drejtat e tyre sebashku në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 8

Eksperti Kontabël i Autorizuar i shoqërisë do të emërohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi dhe për çdo vit financiar shoqëria do të emërojë një ekspert kontabël për të kontrolluar aktivitetin ekonomik të shoqërisë.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutin.

NENI 11



Ortakët detyrohen të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhduken Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12

Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortakët themelues. Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

NENI 13

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve apo ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 14

Dispozita Përfundimtare

Akti i themelimit përpilohet në 4 kopie të njëjta në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Flavieta BALA

Flavieta Bala


Marko BRINJA

Marko Brinja
